

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Prokurori nuk mban më, ironizon Edi Ramën: Kur shteti mbetet në dorën e piktorit, ligji kthehet në Penel (KOMENTI I PLOTË)
ADRESA	https://newsbomb.al/politike/prokurori-nuk-mban-me-ironizon-edi-ramen-kur-shteti-mbetet-ne-doren-e-p-i401044
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	12 shtator 2026, 10:08:59 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	12 shtator 2026, 10:02:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b12298f52fb54f07fc358d874a77ca754d2b9dd0ca0d38cdf8e8e4e117f16a7b
TEKSTI	ecccc991137627ecc5155d1f0c8c9e5ffa8ea5012304f92e63cf1c8b47f3b2cf4
PAMJA	55f31b66bdc849b44ba9d304ba10f575f29aa83baf1d1b92dcd852e0aad8304

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	272bc7653f63e69fd93a679ba57cad83a9f32aa315bcf608703c9dd082765573
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	6d64b19d4495c04a1879b548eb4acc42b7d675e081280586bffd66b65486cb
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/272bc7653f63e69fd93a679ba57cad83a9f32aa315bcf608703c9dd082765573>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

Kreu Politikë Aktualitet Ekonomi Kulturë & Art Rajon Sport Bota Showbiz SocialBomb



Çështjet kryesore

Arrestohet Ergys Agasi

"Retreat"-i i qeverisë në Pogradec!

SPAK godet grupin e Eldi Dizdarit dhe Dritan Gjikës

Politikë

12 Shtator 2026, 12:02

Prokurori nuk mban më, ironizon Edi Ramën: Kur shteti mbetet në dorën e piktorit, ligji kthehet në Penel (KOMENTI I PLOTË)



Shkruar nga Newsbomb



Prokurori Mirjon Brahimllari, autor i këtij koment

Nga Mirjon Brahimllari

Muaji shtator është një muaj shumë i rëndësishëm në historinë e formimit të shtetit, drejtësisë dhe demokracisë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në 17 shtator 1787 u nënshkrua Kushtetuta Amerikane (Constitution day), me parimet e kufizimit të pushtetit dhe vendosjen e drejtësisë në themel të rendit kushtetues. Por Etërit Themelues të Amerikës (the Founding Fathers) nuk e lanë drejtësinë vetëm si një premtim kushtetues. Në 17 shtator 1787 vendosën drejtësinë në themel të kushtetutës, në 24 shtator 1789 Kongresi miratoi "Judiciary Act" me të cilin u ndërtua arkitektura e gjyqësorit, dhe në 25 shtator 1789 u miratua "Bill of Rights" nëpërmjet të cilit u vendosën kufij konkret ndaj pushtetit. Etërit Themelues e dinin që drejtësia nuk mbrohet vetëm me fjalë por ajo kërkon institucione që ta mbrojnë. Jo më kot një prej tyre Aleksander Hamilton shprehej se "Detyra e parë e shoqërisë është drejtësia."

Mësimi i shtatorit amerikan është se drejtësia nuk lihet në mëshirën e pushtetit. Kushtetuta vendos kufirin, gjyqësori ruan kufirin dhe ligji mbron qytetarin kur pushteti tenton ta kapërcëjë atë. Historia na mëson se pavarësia e drejtësisë nuk është privilegj i gjyqtarëve, por është mekanizëm mbrojtës i qytetarit ndaj pushtetit. Një shtet mund të mbijetojë pa shumë gjëra, por pa drejtësi, ai humbet arsyen për të cilën ekziston.

Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



Rajoni

Arratisja e spektakolare e shqiptarit në Greqi, gjendet një nga makina e autorëve, brenda saj kallashnikovë dhe gjurmë gjaku



Bota

Arabia Saudite mbylli tubacionin kritik të naftës pas sulmit me dron, mbulon 5% të transportit global të naftës dhe përdorej për të anashkaluar Ngushticën e Hormuzit

Zbulu më shumë artikuj >

Aristoteli thote se njeriu, kur është në gjendjen e tij më të mirë, është më fisniku i gjallesave; i ndarë nga ligji dhe drejtësia, bëhet më i keq!

Rreth 250 vite me vonë, po në shtator, dhe për dreq po në datën 17 shtator në ditën e Kushtetutës Amerikane, homologët e Etërve Themelues të Amerikës në shtetin më proamerikan në planet, po përgatiten të miratojnë me ligj pagat e magistratëve shqiptar, në zbatim të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, megjithëse jashtë afatit të parashikuar nga ky vendim dhe me shumë gjasë në shkelje të parimeve dhe përcaktimeve që po ky vendim ka parashikuar.

Homologët shqiptar të Etërve Themelues, mbi 10 vite më parë, pasi e grisën dhe telendisën drejtësinë shqiptare, duke e anatemuar në sytë e publikut dhe madje duke e kthyer në armikun publik nr. 1 në vend, i'u rikthyhen edhe një herë avazit të vjetër. Duket është bërë rrugë se çdo dekadë, apo sa herë ka ndonjë ngjarje apo situatë jo të rehatshme për pushtetin, gjendet sistemi i drejtësisë, si mish për top, për të argëtuar masat. Ndryshuan ligjin, dy herë në dy vite, duke e ulur pagën magistratëve, megjithëse ajo është paga e vetme e mbrojtur në Kushtetutë dhe e vetmja pagë që nuk mund të preket nga askush. Madje disa nga parimet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara shkojnë edhe më tej, pasi jo vetëm që ulja apo prekja e pagës së magistratit nuk mund t'i shkojë ndër mend pushteteve të tjera, por edhe rritja e pagës së tyre nuk mund të mbetet në dorë të legjislativit dhe ekzekutivit. Pasi magistratët i'u drejtuan Gjykatës Kushtetuese dhe pritën disa vite, derisa me vendimin e saj u ndërpre shkelja e Kushtetutës, duke u konstatuar ulja e padrejtë e pagës së magistratëve, filloi avazi i vjetër duke trumbetuar kudo se magistratët duan rritje rroge, duan më shumë lekë, po shkallmojnë thesarin e shtetit, ikën paratë publike, pagat e gjyqsorit i miraton legjislativi madje ndonjëherë edhe ekzekutivi fill i vetëm. Kësaj sjelljeje or tu`ngjat`jeta i thonë propagandë e përsëritur me qëllim delegitimimin e pushtetit gjyqsor.

Por është e qartë, për ata që kanë sy e vesh për të parë e dëgjuar, zemër e mendje për të ndjerë e kuptuar, se magistratët nuk kërkojnë rritje rroge, por kërkojnë dinjitet, respekt dhe mbështetje për të përmbushur misionin që Kushtetuta i'u ka ngarkuar dhe për të cilin ata, në krye të herës, janë betuar. Magistratët kërkojnë atë që Etërit Themelues parashikuan me gërma të arta në Kushtetutën Amerikane 250 vite më parë, "Checks and Balances", i cili në thelb ka pavarësinë e pushtetit gjyqsor. Asnjëri pushtet nuk është mbi tjetrin dhe asnjë nuk është nën tjetrin. Të gjithë janë nën Kushtetutën.

Ndërkohë gjysma e shtatorit po kalon dhe sistemi i drejtësisë gjendet përballë faktit absurd dhe të paprecedent ku pagat e gjithë sistemit janë bllokuar me urdhër të Paradhomës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave - (Etërit Themelues ndoshta do dridhen në varr). Mund të jetë e pabesueshme se si një urdhër i tillë, "i Paradhomës", është zbatuar menjëherë dhe me sy mbyllur nga të gjitha degët e thesarit të Republikës, duke paralizuar në këtë mënyrë një nga 3 pushtetet e vetë shtetit, por duket se tek ne, paradhoma e pushtetit është korridor i ku ligji humbet zërin dhe urdhri fiton pushtetin. Nëse paga e një gjyqtari mund të bllokohet nga një zyrë e pushtetit ekzekutiv, atëherë pavarësia e gjyqtarit mund të ekzistojë në Kushtetutë, por kjo allasoj pavarësie vihet në pikëpyetje edhe nga një degë thesari apo nga një paradhomë.

Kjo historia e Paradhomës të kujton shprehjen e Apelles, një prej piktorëve më të famshëm të Greqisë së lashtë, "O këpucar, mos shko përtej sandales." Dhe meqënëse jemi tek piktorët, ndoshta kur shteti mbetet në dorë të piktorëve, ligji rrezikon të bëhet vetëm një penel në dorën e pushtetit.

Përvec historisë së Apelles, në mitologjinë greke është shumë interesant edhe miti i Ikarusit (tejkalimi i kufirit sjell rënien). Dedali ndërton krahë prej pendësh dhe dylli për veten dhe djalin e tij, Ikarusin, që të arratisen nga Kreta. Para fluturimit, Dedali e paralajmëron: mos fluturo shumë ulët dhe as shumë lart. Ikarusi, i dehur nga ndjenja e lirisë dhe fuqisë së re, ngrihet gjithnjë e më lart. Dielli shkrin dyllin, krahët shpërbëhen dhe ai bie në det.

Në një shtet të së drejtës, çdo pushtet ka këpucën e vet dhe çdo kompetencë ka kufirin e vet. Të kalosh njërin është si të bëhesh këpucar i Apelles përtej këpucës; të fluturosh përtej tjetrit është të përsëritësh fatin e Ikarusit.

Sondazh

Poll



E Shtunë 11:22

"Farsa është në ditët e fundit", Edi Rama në mbështetje të çlirimtarëve: Hashim Thaçi do të triumfojë me forcën e të vërtetës së tij



Politikë

"Tallje, Besë e shkelur", banorët e Përmetit dhe Këlcyrës akuzojnë Mirela Kumbaron: Hera e dytë që nuk vjen në takim, dërgon kryetarët e degëve të PS

E Shtunë 08:19



Politikë

Rama e shkarkoi, gazetarja zbardh detaje: Lamallari nuk ishte i informuar, do të udhëtonte në Lushnje

E Premte 23:09



E Premte 22:22

"Prania Besnike", Braçe takim me banorët e Selitës: Plehurat, siguria dhe legalizimet, problemet kryesore





Politikë

Rama për paraburgimin e Ilir Metës: Nuk jam njeri hakmarrës, ndiej keqardhje, ishte talent i madh por u katandis në një personazh qesharak

E Premte 21:27



Politikë


Arben Ahmetaj hodhi akuza të forta ndaj tij, Rama i zhgënjyer nga ish-zv.kryeministri: Kam investuar në një "maskë karnavalesh" dhe "burim të ndotur"

E Premte 21:09



E Premte 20:55

"Jo vetëm administrata është arrogante, arrogantë jemi kudo, edhe kur kalojmë rrugën", Rama paralajmëron: Performanca e keqe do të ndëshkohet



Politikë

"Nëse janë pjesë e PS-së, s'e dinë", Rama tregon për herë të parë si i zgjedh ministrat: Jam unë "trajneri" dhe nuk negocioj nëse do "luash" në "formacion"

E Premte 20:39



Politikë

104 ditë protestë, Rama paralajmëron sërish qytetarët: Kujdes nga "kokat" e tubimit! Vijnë me axhendë dhe me sponsor nga pas

E Premte 19:24



🕒 E Premte 19:08

“Kam udhëtuar 1.6 milionë km në Shqipëri dhe i njoh hallet e njerëzve”, Rama flet për protestën: Edhe unë jam tubues



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.